

BASHKIA DURRES
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Për: **EVEREST** + FUSHA Adresa: TIRANE, Kamez, Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit.

Procedura e prokurimit: Proçedurë e hapur per Pune.

Përshkrim i shkurtër i kontratës : **“Rivitalizimi i sheshit Publik para hyrjes se portit”**, me fond limit **487’461’000** lekë, sasia sipas preventivit, afati **270 dite**.

Publikime të mëparshme(*nëse zbatohet*):Buletini i Njoftimeve Publike.[**Nr.34, date 29 Gusht 2016**]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X**, oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qene pjesemarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. EVEREST**J78311921L**

+ FUSHA

J61922018S

Vlera 451'529'540(Katerqind e pesedhjetë e një milion e peseqind e njezet e nente mije e peseqind e dyzet)leke

2. Bitupave LLC**L52317039A**

Vlera 453'520'294(Katerqind e pesedhjetë e tre milion e peseqind e njezet mije e dyqind e nentedhjetë e kater)leke

3. ALKO-IMPEX General Construcion**K91326028I**

Vlera 457'914'960(Katerqind e pesedhjetë e shtate milion e nenteqind e katermbedhjetë mije e nenteqind e gjashtedhjetë)leke

4. ROSI

Nuk ka paraqitur oferte

Jane s'kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

Bitupave LLC**ALKO-IMPEX General Construcion****ROSI**

Per arsyet e meposhtme:

- Ofertuesi **Bitupave LLC** me vlere te ofertes **453'520'294** leke, **nuk** ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit;

1- Per kriterin e meposhtem te kerkuar ne DT;

h. Licënsa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

NP.1-A, NP.4-C, NP.5-B, NP.7-A, NP.12-A, NS.1-A, NS.4-C, NS.7-A, NS.8-D, NS.9-F, NS.10-A, NS.18-A.

Operatori **Bitupave LLC** dege e shoqerise se huaj **De Looimolen LLC (HOLLANDE)**, nuk ploteson kriterin per piken "NS.9-F" te licences pasi kjo shoqeri disponon respektivisht "NS.9-E".

2- Per kriterin e meposhtem te kerkuar ne DT;

j. Staf i teknik i shoqerise te kete ne perberje:

k. Inxhinier Ndertimi me eksperience minimale pune 10 vite

l. Inxhinier Hidroteknik me eksperience minimale pune 10 vite

m. Inxhinier Mekanik me eksperience minimale pune 10 vite

n. Inxhinier Gjeodet me eksperience minimale pune 10 vite

o. Arkitekt me eksperience minimale pune 5 vite

p. Ing mjedisi me eksperience minimale pune 5 vite

q. Inxhinier Gjeolog me eksperience minimale pune 5 vite

r. Drejtus mjeti 12 punonjes

s. Puntori e specializuar me makineri, manovratore 14 punonjes

t. Puntori e specializuar konstruksione metalike(saldator) 4 punonjes

u. Puntori e specializuar ne ndertim, murator, karpentier 20 punonjes

v. Puntori e specializuar konstruksione metalike(montator) 20 punonjes

w. Puntore te thjeshte 43 punonjes

Operatori **Bitupave LLC dege e shoqerise se huaj De Looimolen LLC (HOLLANDE)**, ka paraqitur deklarata dhe kontrata pune per numrin e inxhinierëve dhe punonjesve, te perkthyer ne gjuhen Shqipe, te pa shoqeruara me diplomat perkatese per te gjithë inxhinieret dhe pa nje dokument zyrtar qe verteton se te gjithë punonjesit e kerkuar ne piken 2 jane te specializuar.

3- Per kriterin e meposhtem te kerkuar ne DT;

1. *Kerkohet certifikate ISO 9001 e prodhuesit per cilesine e produkteve te kerkuara me poshte:*

- *OBJEKTE PREJ CELIKU (S355J2) F.v per trare dhe kollona me elemente skatolare. Jane perfshire: pllakat e bashkimit dhe rigjidimit (te klases se dhene ne fletet e projektit); prerja sipas permasave; shpimet e vrimave; fllanxhat; bullonimet (me bullona te cdo lloj klase) ose saldimi; ankerat per ankorimin ne strukturat prej betoni te armuar. Te detajuar ne projekt, preventivin ne zerin me nr. E01.03 dhe ne specifikimet teknike;*

per kete kriter, operatori **Bitupave LLC dege e shoqerise se huaj De Looimolen LLC (HOLLANDE)** ka nje kontrate furnizimi me **PIRRAÇI U-06 SHPK (TIRANE)**. Çertifikata **ISO 9001** e furnizuesit **PIRRAÇI SHPK** eshte per Projektim, zhvillim, instalimi i konstruksioneve metalike dhe **jo certifikate ISO 9001 prodhuesi**, gjithashtu kjo certifikate nuk ka date leshimi dhe skadimi per te kuptuar vlefshmerine e kesaj certifikate.

4- Per kriterin e meposhtem te kerkuar ne DT;

m. *List pagesat sipas formuleve standarte per sigurimet, qe i takojnë periudhës Janar-Korrik 2016, ku numer i punonjesve te jete minimumi 120 persona (perfshire dhe numrin e punonjësve te stafit sipas pikës “j”) Dokumenta te konfirmuara nga institucioni përkatës. Shoqëruar me:*

Formularët e deklarimit te kontributeve te sig shoqerore dhe shendetesore (FDP)

Formularët e deklarimit te te ardhurave nga punesimi (TAP)

Mandat pagesat e FDP dhe TAP

Operatori **Bitupave LLC dege e shoqerise se huaj De Looimolen LLC (HOLLANDE)**, ka paraqitur nje pasqyre pagash te punonjesve perkthyer ne gjuhen Shqipe ku tregon: Numrin e punonjesve(ku ofertuesi e permbush kriterin minimumi 120 persona), nder te tjera dhe pagesen e pensionit, por ne asnje rast nuk pasqyrohen emrat e punonjesve per te kuptuar detyren profesionale te tyre si: *Inxhinier Ndertimi, Inxhinier Hidroteknik, Inxhinier Mekanik, Inxhinier Gjeodet, Ing mjedisi, Inxhinier Gjeolog Drejtus mjeti, manovratore, saldator, karpentier, montator etj.*

Operatori **Bitupave LLC dege e shoqerise se huaj De Looimolen LLC (HOLLANDE)**, ne ekstraktin historik QKB_se, te dates 22/08/2016,rezulton se perfaqesuesit ligjor **Z.Alfred Marku** dhe **Z.George Wilhelm Fokker** nuk korrespondojne afatet e emerimit te tyre me listepagesat perkatese. Gjithashtu ky operator per degen e perfaqesimit ne Shqiperi dhe ne Hollande nuk ka paraqitur *Formularët e deklarimit te kontributeve te sig shoqerore dhe shendetesore (FDP), Formularët e deklarimit te te ardhurave nga punesimi (TAP) dhe Mandat pagesat e FDP dhe TAP, formule te cilat shoqerojne listepagesat perkatese.*KVO vendos qe ofertuesi **te mos kualifikohet.**

- **Ofertuesi ALKO-IMPEX General Construcion** me vlere te ofertes **457'914'960** lekë, **nuk** ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit;

1- Per kriterin e meposhtem te kerkuar ne DT;

i. *Liçensa profesionale e shoqerise lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:*

NP.1-A, NP.4-C, NP.5-B, NP.7-A, NP.12-A, NS.1-A, NS.4-C, NS.7-A, NS.8-D, NS.9-F, NS.10-A, NS.18-A.

Operatori **ALKO-IMPEX General Construcion**, nuk ploteson kriterin per piken “NS.8-D” dhe “NS.9-F” te licences pasi kjo shoqeri i disponon respektivisht “NS.8-C” dhe “NS.9-E”.

2- Per kriterin e meposhtem te kerkuar ne DT;

2. *Kerkohet certificate ISO 9001 e prodhuesit per cilesine e produkteve te kerkuara me poshte:*

➤ Mermer i bardhe (bianco carrara c).

per kete kriter, operatori **ALKO-IMPEX General Construcion** ka nje kontrate furnizimi me **ADEL SHPK (KORCE)**, ku nuk ka paraqitur dokumenta teknike (prospekte teknike, katalog etj.) per Mermer i bardhe (bianco carrara c). KVO vendos qe ofertuesi **te mos kualifikohet**.

- Ofertuesi **ROSI** nuk ka oferte. KVO vendos qe ofertuesi **te mos kualifikohet**.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **EVEREST+FUSHA** Adresa: TIRANE, Kamez, Fabrika ne Rrugen Nacionale, Prane Nyjes se Betonit, me një vlerë të përgjithshme prej **451’529’540**(Katerqind e pesedhjetë e një milion e peseqind e njetzet e nente mije e peseqind e dyzet)leke, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkise Durres ne Njesine e Prokurimit, tel/fax 052 800 941, kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtedhjetë) diteve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 27.09.2016

Ankesa: ka ose jo __ **Jo** __

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____